



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 108/3 prot.

Tiranë, më 30.1 2025

V E N D I M
Nr. 1, datë 30.1.2025

P Ë R
PROVIMIN E PRANIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2025 – 2026

Në mbështetje të neneve 248, 262, 266 të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, neneve 52, 53 dhe 58 të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, si edhe neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, i mbledhur më datë 30.1.2025,

V E N D O S I:

1. Të fillojnë procedurat për organizimin e provimit të pranimit për vitin akademik 2025 – 2026.
2. Numri i vendeve vakante për pranimin në Programin e Formimit Fillestar për kandidatë për magjistratë do të jetë 22 kandidatë, nga të cilët 10 kandidatë profili gjyqtar dhe 12 kandidatë profili prokuror.
3. Numri i vendeve vakante për pranimin në Programin e Formimit Fillestar për kandidatë për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë do të jetë 3 kandidatë për këshilltarë ligjorë në prokurori dhe 3 kandidatë për ndihmës ligjorë në gjykatë.
4. Numri i vendeve vakante për pranimin në Programin e Formimit Fillestar për kandidatë për avokat shtetit do të jetë 7 kandidatë për profilin avokat shteti në nivel vendor (pranë ministrive/zyrave vendore).
5. Periudha e regjistrimit për kandidatët për magjistratë do të jetë 1 – 28 shkurt 2025.
6. Provimi i pranimit do të zhvillohet në datat:
 - 22 prill 2025 - Faza e parë
 - 24 - 25 prill 2025 - Faza e dytë.
7. Ngarkohet Shkolla e Magjistraturës për ndjekjen e procedurave të organizimit të këtij provimi.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.